

Workshop "Perspektivat globale të prodhimit bujqësor" në bashkëpunim me AgrifertradeS



U zhvillua në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" workshopi me titull "Perspektivat globale të prodhimit bujqësor", mbajtur nga administratori i firmës AgrifertradeS Arqile Mato, anëtar i Bordit Këshillimor të Biznesit të UE-së.

Gjatë këtij workshop-i, z. Mato, shpjegoi rëndësinë, nevojën, përfitimet dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore për biostimulantët.

Të pranishëm në sallë ishin edhe dy pedagoget: Blerina Pupuleku dhe Edlira Pajenga, të cilat gjithashtu patën një sërë pyetjesh drejtuar zotit Mato.

Në mbyllje të takimit u kërkua nga studentët dhe nga ana e pedagoqeve të diskutohet mundësia për të zhvilluar praktikën 2-javore pranë kësaj kompanie, për studentët e vitit të fundit të programit Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisi.

